



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT – RAPORT

PËR
AUDITIMIN ME BAZË SISTEMI
MBI
“ANGAZHIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR
DETYRIMET FINANCIARE TË PRAPAMBETURA NË
BASHKINË ROSKOVEC”.

Periudha e audituar: deri 30.09.2020

Grupi i auditëve : Gëzim HABILI

Eltona ÇEPELE

Gilda Zyka

Roskovec, Dhjetor, 2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT RAPORT

***MBI ANGAZHIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR DETYRIMET FINANCIARE
TË PRAPAMBETURA NË BASHKINË ROSKOVEC.***

Mbahet sot më datë 16.12.2020 nga grupi i punës së audituesve të Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë Bashkisë Roskovec, mbi angazhimin e auditimit për ***“Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe analizimit të masave të marra për moskrijimin e detyrimeve, në kuadër të objektivit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i cili do të synonte në moskrijimin e detyrimeve financiare të prapambetura, për të patur një sistem të shëndetshëm të menaxhimit financiar”***.

Angazhimi i auditimit në këtë subjekt u mbështet në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm) me nr. 19310, datë 16.10.2020, si dhe programin e auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë. Qasja e këtij misioni angazhim auditimi dhe procedurat për auditimin e detyrimeve të prapambetura, mbështeten në Udhëzimet mbi formatin e Programit të Auditimit dhe Gjurmën e Auditimit të përcaktuara në shkresën nr. 22772, datë 27.12.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

I. Përmbledhje ekzekutive.

Sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë me shkresën nr. 6374 prot. datë 24.11.2020, ***“Mision auditimi për detyrimet financiare të prapambetura në Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Roskovec”***, grupi i auditimit i përbërë nga Përgjegjës grupi z. Gëzim Habili dhe audituese zj. Gilda Zyka e zj. Eltona Çepele, realizoi misionin e angazhimit të auditimit në Drejtorinë Ekonomike (Sektori i Financës) dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Roskovec.

Qëllimi i këtij mision auditimi është vlerësimi i frytshmërisë së procesit të menaxhimit financiar, vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe analizimit të masave të marra për moskrijimin e detyrimeve financiare të prapambetura, dhënia e sigurisë objektive dhe konsulencës.

II. Hyrje

Gjatë kryerjes së misionit të auditimit, nga grupi i auditimit është synuar një vlerësim në tërësi i sistemit në përputhje me Udhëzimet dhe metodikat e miratuara, me qëllim që sistemet e menaxhimit financiar e të kontrollit si dhe performanca e njësisë së audituar, të jenë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, rregullshmërisë, dobisë, frytshmërisë dhe kursimit.

Auditimi është realizuar nga data 02.12.2020 deri më 15.12.2020, gjithsej 10 (dhjetë) ditë pune, për periudhën e audituar ***deri 30.09.2020***.

Janë diskutuar në Takimin fillestar (të Hapur) me D/Drejtorisë Ekonomike z. Selman Çepele, P/Sektorit të Financës zj. Edlira Toro, P/Sektorit të Biznesit zj. Ditmira Dhima, P/Sektorit të Tatim – Taksave zj. Donika Goga, si dhe me punonjës të tjerë të këtyre Drejtorive, objektivat, formatet, metodat e auditimit, linjat e komunikimit, si dhe afatet për raportime.

Gjatë këtij misioni auditimi janë realizuar të gjitha pikat e programit sipas tematikës së miratuar. Pasi ka përfunduar edhe puna në terren, janë diskutuar gjetjet (**konstatimet**) e këtij misioni auditimi me stafin e Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë të të Ardhurave Vendore të Bashkisë Roskovec dhe është rënë dakort për çështjet e dala.

III. Metoda e Auditimit.

Gjatë realizimit të misionit të auditimit, grupi i punës i auditimit ka punuar në përputhje me udhëzimet dhe metodikat e miratuara. Është mbuluar me auditim periudha ***deri 30.09.2020***. Audituesit janë njohur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe kanë bërë një vlerësim në tërësi të sistemit. Komunikimi i qartë, konçiz dhe në kohë me stafin e njësisë së audituar ka ndihmuar në efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të auditimit.

Auditimi u krye në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Urdhërit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe në zbatim të shkresës nr. 19310, datë 16.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila nga ana e saj rekomandon që qasja e këtij misioni angazhim auditimi dhe procedurat për auditimin e detyrimeve të prapambetura, të mbështeten në Udhëzimet mbi formatin e Programit të Auditimit dhe Gjurmën e Auditimit të përcaktuara në shkresën nr. 22772, datë 27.12.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet.

Nga auditimi rezultoi se :

Drejtorja Ekonomike dhe Drejtorja e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Roskovec, e ushtrojnë aktivitetin e tyre në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e

Sistemit Buxhetor në RSH” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, etj.

I. Auditimi mbi sistemin e të ardhurave.

A. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.

Nga auditimi sipas programit të miratuar, të sistemit të të ardhurave nga taksat, tatimet e tarifat, rezultoi se niveli i planifikuar ishte në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore” me ndryshimet përkatëse, si dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për 2 vitet e fundit (2019 e 2020), miratimi i planifikuar i të ardhurave ishte bërë me Vendimet e Këshillit Bashkiak nr. 104, datë 19.12.2018 dhe nr. 116, datë 20.12.2019, të cilët janë konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier (respektivisht me shkresat nr. 2112/1, datë 28.12.2018 dhe nr. 1969/1, datë 30.12.2019).

Kështu, për vitin 2019 janë planifikuar të ardhura vjetore në shumën 513.573.0 mijë lekë, të cilat janë realizuar në shumën 262.421,5 mijë lekë ose në masën 51.1 %, ndërsa për vitin 2020, këto të ardhura janë planifikuar në shumën 456.381,0 mijë lekë dhe kemi realizim të tyre (deri më 30 Shtator) në shumën 151.961,8 mijë lekë ose në masën 33.3 %.

Duke krahasuar të dhënat për vitet 2019 dhe 2020, vërejmë se këto të ardhura ndonëse kanë pësuar rritje në planifikim (për vitin 2019, kemi rritje prej 1.94 herë përkundrejt planifikimit të vitit 2018, dhe 2.7 herë përkundrejt realizimit të këtij viti), realizimi i tyre për vitin 2019 është në nivele të ulëta (51.1 %), kurse për vitin 2020, krahasuar me vitin paraardhës kemi ulje të planifikimit në masën 88.8 %, realizimi i tyre (deri më 30 Shtator 2020) është në nivele edhe më të ulëta (me vetëm 33.3 %), çka pasqyrohet në rubrikën pasuese. Pritshmëria e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore për periudhën e mbetur të vitit korrent, është entuziaste.

Për sa më sipërcilësuar, **vlerësojmë** se planifikimi i të ardhurave për të dy vitet e fundit, nuk është bërë mbi baza reale.

B. Evidentimi i debitorëve.

Gjatë këtij misioni angazhim auditimi rëndësi sidomos ju kushtua edhe evidentimit të **debitorëve** në vite. Me këtë rast **konstatohet** se, *detyrimet e prapambetura e të pa mbledhura (të pa arkëtuara) deri më 30.09.2020, kanë gjetur pasqyrimin e vetë në bilancet e viteve respektive në Klasën 4 “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” (llog. 468), për të cilat nga kqyrja e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, rezulton se ka evidentim të debitorëve si në numër dhe në vlerë.*

Të dhëna më të plota për gjendjen e debitorëve (në vlerë dhe numër), i gjejmë në pasqyrat e mëposhtëme :

Debitorët e Taksave dhe Tarifave deri më 30.09.2020 (Në vlerë).

Në lekë

| NR. | EMERTIMI | LLOJI TAKSËS | | | | TOTALI |
|-----|----------------|-------------------|-------------------|----------------|------------------|-------------------|
| | | TOKE | NDËRTESE | TRUALLI | TË TJERA | |
| 1 | NJ.A. ROSKOVEC | 9.414.076 | 2.978.982 | 32.360 | 3.778.620 | 16.204.038 |
| 2 | NJ.ADM. STRUM | 32.697.615 | 5.971.993 | 39.960 | 2.003.368 | 40.712.936 |
| 3 | NJ.ADM. KUMAN | 11.643.651 | 4.126.646 | 30.200 | 1.891.750 | 17.692.247 |
| 4 | NJ.ADM. KURJAN | 9.519.354 | 1.651.658 | 20.664 | 373.884 | 11.565.560 |
| | SHUMA | 63.274.696 | 14.729.279 | 123.184 | 8.047.622 | 86.174.781 |

Debitorët e Taksave dhe Tarifave deri më 30.09.2020 (Në numër).

| NR. | EMERTIMI | LLOJI TAKSËS | | | | TOTALI |
|-----|----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|
| | | TOKE | NDËRTESE | TRUALLI | TË TJERA | |
| 1 | NJ.A. ROSKOVEC | 554 | 816 | 816 | 816 | 3.002 |
| 2 | NJ.ADM. STRUM | 1.014 | 1.336 | 1.336 | 1.336 | 5.022 |
| 3 | NJ.ADM. KUMAN | 806 | 914 | 914 | 914 | 3.548 |
| 4 | NJ.ADM. KURJAN | 475 | 491 | 491 | 491 | 1.948 |
| | SHUMA | 2.849 | 3.557 | 3.557 | 3.557 | 13.520 |

Për të bërë një pasqyrim më analitik të debitorëve të Taksave, Tatimeve dhe Tarifave të sipër cilësuara, do të na ndihmonin pasqyrat si më poshtë.

Kështu, për Taksën e Tokës kemi :

Debitorët e Taksës së Tokës deri më 30.09.2020 (Në vlerë sipas viteve).

Në lekë

| NR. | EMERTIMI | TAKSA E TOKES SIPAS VITEVE | | | | TOTALI |
|-----|-----------|----------------------------|-----------|-----------|-----------|------------|
| | | ROSKOVEC | STRUM | KUMAN | KURJAN | |
| 1 | Viti 2011 | 406.046 | 2.464.373 | 371.143 | 395.638 | 3.637.200 |
| 2 | Viti 2012 | 551.637 | 2.659.396 | 386.765 | 632.892 | 4.230.690 |
| 3 | Viti 2013 | 658.691 | 2.826.452 | 445.904 | 644.131 | 4.575.178 |
| 4 | Viti 2014 | 803.417 | 2.910.118 | 521.187 | 732.048 | 4.966.770 |
| 5 | Viti 2015 | 937.123 | 3.209.111 | 710.866 | 752.885 | 5.609.985 |
| 6 | Viti 2016 | 1.053.278 | 3.685.121 | 1.256.044 | 932.764 | 6.927.207 |
| 7 | Viti 2017 | 1.357.666 | 4.238.239 | 2.078.648 | 1.608.376 | 9.282.929 |
| 8 | Viti 2018 | 1.605.368 | 4.871.700 | 2.638.549 | 1.566.172 | 10.681.789 |

| | | | | | | |
|---|--------------|------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|
| 9 | Viti 2019 | 2.040.850 | 5.833.105 | 3.234.545 | 2.254.448 | 13.362.948 |
| | SHUMA | 9.414.076 | 32.697.615 | 11.643.651 | 9.519.354 | 63.274.696 |

Debitorët e Taksës së Tokës deri më 30.09.2020 (Në numër sipas viteve).

Në lekë

| NR. | EMERTIMI | NUMRI I FAMILJEVE | VLERA DEBITORE |
|----------|---------------------------------------|-------------------|-------------------|
| A | Njësia Administrative Roskovec | | |
| | -VITI 2011 | 132 | 406.046 |
| | -VITI 2012 | 159 | 551.637 |
| | -VITI 2013 | 183 | 658.691 |
| | -VITI 2014 | 231 | 803.417 |
| | -VITI 2015 | 250 | 937.123 |
| | -VITI 2016 | 293 | 1.053.278 |
| | -VITI 2017 | 378 | 1.357.666 |
| | -VITI 2018 | 444 | 1.605.368 |
| | -VITI 2019 | 554 | 2.040.850 |
| | SHUMA (A) | | 9.414.076 |
| B | Njësia Administrative Strum | | |
| | -VITI 2011 | 500 | 2.464.373 |
| | -VITI 2012 | 535 | 2.659.396 |
| | -VITI 2013 | 579 | 2.826.452 |
| | -VITI 2014 | 592 | 2.910.118 |
| | -VITI 2015 | 649 | 3.209.111 |
| | -VITI 2016 | 751 | 3.685.121 |
| | -VITI 2017 | 812 | 4.238.239 |
| | -VITI 2018 | 978 | 4.871.700 |
| | -VITI 2019 | 1014 | 5.833.105 |
| | SHUMA (B) | | 32.697.615 |
| C | Njësia Administrative Kuman | | |
| | -VITI 2011 | 144 | 371.143 |
| | -VITI 2012 | 149 | 386.765 |
| | -VITI 2013 | 162 | 445.904 |
| | -VITI 2014 | 185 | 521.187 |
| | -VITI 2015 | 236 | 710.866 |
| | -VITI 2016 | 349 | 1.256.044 |
| | -VITI 2017 | 514 | 2.078.648 |
| | -VITI 2018 | 642 | 2.638.549 |

| | | | |
|----------|-------------------------------------|-----|-------------------|
| | -VITI 2019 | 806 | 3.234.545 |
| | SHUMA © | | 11.643.651 |
| D | Njësia Administrative Kurjan | | |
| | -VITI 2011 | 77 | 395.638 |
| | -VITI 2012 | 100 | 632.892 |
| | -VITI 2013 | 115 | 644.131 |
| | -VITI 2014 | 125 | 732.048 |
| | -VITI 2015 | 146 | 752.885 |
| | -VITI 2016 | 157 | 932.764 |
| | -VITI 2017 | 219 | 1.608.376 |
| | -VITI 2018 | 261 | 1.566.172 |
| | -VITI 2019 | 475 | 2.254.448 |
| | SHUMA (D) | | 9.519.354 |
| | TOTALI (A+B+C+D) | | 63.274.696 |

Për Taksën e Ndërtesës :

Debitorët e Taksës së Ndërtesës deri më 30.09.2020 (Në vlerë sipas viteve).

Në lekë

| NR. | EMERTIMI | TAKSA E NDERTESËS SIPAS VITEVE | | | | TOTALI |
|-----|--------------|--------------------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|
| | | ROSKOVEC | STRUM | KUMAN | KURJAN | |
| 1 | Viti 2011 | 97.471 | - | - | - | 97.471 |
| 2 | Viti 2012 | 151.585 | - | - | - | 151.585 |
| 3 | Viti 2013 | 157.405 | - | - | - | 157.405 |
| 4 | Viti 2014 | 167.251 | - | - | - | 167.251 |
| 5 | Viti 2015 | 173.912 | - | - | - | 173.912 |
| 6 | Viti 2016 | 190.186 | - | - | 397.845 | 588.031 |
| 7 | Viti 2017 | 240.202 | 2.092.314 | 969.128 | 90.078 | 3.391.722 |
| 8 | Viti 2018 | 795.790 | 1.942.412 | 1.574.229 | 509.938 | 4.822.369 |
| 9 | Viti 2019 | 1.005.180 | 1.937.267 | 1.583.289 | 653.797 | 5.179.533 |
| | SHUMA | 2.978.982 | 5.971.993 | 2.939.190 | 1.651.658 | 14.729.279 |

Debitorët e Taksës së Ndërtesës deri më 30.09. 2020 (Në numër sipas viteve).

Në lekë

| NR. | EMERTIMI | NUMRI I | VLERA |
|-----|----------|---------|-------|
|-----|----------|---------|-------|

| | | FAMILJEVE | DEBITORE |
|----------|---------------------------------------|------------------|-------------------|
| A | Njësia Administrative Roskovec | | |
| | -VITI 2011 | 200 | 97.471 |
| | -VITI 2012 | 294 | 151.585 |
| | -VITI 2013 | 308 | 167.251 |
| | -VITI 2014 | 325 | 167.251 |
| | -VITI 2015 | 337 | 173.912 |
| | -VITI 2016 | 371 | 190.186 |
| | -VITI 2017 | 369 | 240.202 |
| | -VITI 2018 | 599 | 795.790 |
| | -VITI 2019 | 784 | 1.005.180 |
| | SHUMA (A) | | 2.978.982 |
| B | Njësia Administrative Strum | | |
| | -VITI 2011 - 2017 | 1130 | 2.092.314 |
| | -VITI 2018 | 1235 | 1.942.412 |
| | -VITI 2019 | 1336 | 1.937.267 |
| | SHUMA (B) | | 5.971.993 |
| C | Njësia Administrative Kuman | | |
| | -VITI 2011 - 2017 | 805 | 969.128 |
| | -VITI 2018 | 911 | 1.574.229 |
| | -VITI 2019 | 917 | 1.583.289 |
| | SHUMA © | | 4.126.646 |
| D | Njësia Administrative Kurjan | | |
| | -VITI 2011 – 2016 | 254 | 397.845 |
| | -VITI 2017 | 319 | 90.078 |
| | -VITI 2018 | 377 | 509.938 |
| | -VITI 2019 | 491 | 653.797 |
| | SHUMA (D) | | 1.651.658 |
| | TOTALI (A+B+C+D) | | 14.729.279 |

Njësitet Administrative Strum, Kuman dhe Kurjan, e kanë Taksën e Ndërtesës nga viti 2011 - 2017 të përmbledhur, pasi në atë vit është krijuar Rregjistri Elektronik.

Për Taksën e Truallit dhe Tarifat e Shërbimit :

Debitorët e Taksës së Truallit deri më 30.09.2020 (Në vlerë sipas viteve).

Në lekë

| NR. | EMËRTIMI | TAKSA E TRUALLIT SIPAS VITEVE | | | | TOTALI |
|-----|----------------|-------------------------------|---------------|---------------|---------------|----------------|
| | | ROSKOVEC | STRUM | KUMAN | KURJAN | |
| 1 | Viti 2011-2018 | - | - | - | - | - |
| 2 | Viti 2019 | 32.360 | 39.960 | 30.200 | 20.664 | 123.424 |
| | SHUMA | 32.360 | 39.960 | 30.200 | 20.644 | 123.423 |

Debitorët e Taksës së Truallit deri më 30.09.2020 (Në numër sipas viteve).

Në lekë

| NR. | EMËRTIMI | NUMRI I FAMILJEVE | VLERA DEBITORE |
|----------|---------------------------------------|-------------------|----------------|
| A | Njësia Administrative Roskovec | | |
| | -VITI 2011-2018 | - | - |
| | -VITI 2019 | 809 | 32.360 |
| | SHUMA (A) | | 32.360 |
| B | Njësia Administrative Strum | | |
| | -VITI 2011-2018 | - | - |
| | -VITI 2019 | 1336 | 39.960 |
| | SHUMA (B) | | 39.960 |
| C | Njësia Administrative Kuman | | |
| | -VITI 2011-2018 | - | - |
| | -VITI 2019 | 917 | 30.200 |
| | SHUMA © | | 30.200 |
| D | Njësia Administrative Kurjan | | |
| | -VITI 2011-2018 | - | - |
| | -VITI 2019 | 491 | 20.664 |
| | SHUMA (D) | | 20.664 |
| | TOTALI (A+B+C+D) | | 123.184 |

Debitorët e Tarifës së shërbimit deri më 30.09.2020 (Në vlerë sipas viteve).

Në lekë

| N R. | EMËRTIMI | TAKSA E SHËRBIMEVE SIPAS VITEVE | | | | TOTALI |
|------|----------|---------------------------------|-------|-------|--------|--------|
| | | ROSKOVEC | STRUM | KUMAN | KURJAN | |

| | | | | | | |
|----------|----------------|------------------|------------------|------------------|----------------|------------------|
| 1 | Viti 2011-2018 | 2.099.920 | 1.068.868 | 1.061.050 | 294.484 | 4.524.322 |
| 2 | Viti 2019 | 1.678.700 | 934.500 | 830.700 | 344.400 | 3.788.300 |
| | SHUMA | 3.778.620 | 2.003.368 | 1.891.750 | 373.884 | 8.312.622 |

Debitorët e Tarifës së shërbimit deri më 30.09.2020 (Në numër sipas viteve).

| NR. | EMËRTIMI | NUMRI I FAMILJEVE | VLERA DEBITORE |
|----------|---------------------------------------|-------------------|------------------|
| A | Njësia Administrative Roskovec | | |
| | -VITI 2011-2018 | 548 | 2.099.920 |
| | -VITI 2019 | 816 | 1.678.700 |
| | SHUMA (A) | | 3.778.620 |
| B | Njësia Administrative Strum | | |
| | -VITI 2011-2018 | 1235 | 1.068.868 |
| | -VITI 2019 | 1336 | 934.500 |
| | SHUMA (B) | | 2.003.368 |
| C | Njësia Administrative Kuman | | |
| | -VITI 2018-2018 | 911 | 1.061.050 |
| | -VITI 2019 | 917 | 830.700 |
| | SHUMA © | | 1.891.750 |
| D | Njësia Administrative Kurjan | | |
| | -VITI 2011-2018 | 377 | 29.484 |
| | -VITI 2019 | 491 | 344.400 |
| | SHUMA (D) | | 373.884 |
| | TOTALI (A+B+C+D) | | 8.047.622 |

Ndërsa, gjendjen e subjekteve debitore që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin (juridiksionin) e Bashkisë Roskovec, e gjejmë në pasqyrat e mëposhtëme :

Subjektet Debitorë deri më 30.09.2020 (Në vlerë).

Në lekë

| NR. | EMERTIMI | NUMRI I SUBJEKTEVE | VLERA DEBITORE |
|----------|--------------------------------|--------------------|----------------|
| 1 | Njësia Administrative ROSKOVEC | 50 | 4.739.802 |
| 2 | Njësia Administrative STRUM | 80 | 6.701.767 |
| 3 | Njësia Administrative KUMAN | 25 | 1.670.091 |
| 4 | Njësia Administrative KURJAN | 18 | 1.479.208 |

| | | | |
|--|--------------|------------|-------------------|
| | SHUMA | 173 | 14.590.868 |
|--|--------------|------------|-------------------|

Subjektet Debitore deri më 30.09.2020 (Në numër sipas viteve).

Në lekë

| NR. | EMERTIMI | NUMRI I SUBJEKTEVE | PRINCIPLALI | KAMATVONESA | VLERA DEBITORE |
|----------|---|-----------------------|------------------|---------------------|---------------------|
| A | Njësia Administrative Roskovec | | | | |
| | -VITI 2011 | 3 | 76.850 | 16.830,15 | 93.680,15 |
| | -VITI 2012 | 8 | 175.500 | 38.434,50 | 213.934,50 |
| | -VITI 2013 | 11 | 440.430 | 96.454,17 | 536.884,17 |
| | -VITI 2014 | 7 | 231.760 | 50.755,44 | 282.515,44 |
| | -VITI 2015 | 18 | 577.180 | 126.402,42 | 703.582,42 |
| | -VITI 2016 | 19 | 608.670 | 133.298,73 | 741.968,73 |
| | -VITI 2017 | 21 | 612.160 | 134.063,04 | 746.223,04 |
| | -VITI 2018 | 16 | 357.025 | 110.182,00 | 467.207,00 |
| | -VITI 2019 | 26 | 779.165 | 174.642,00 | 953.807,00 |
| | SHUMA (A) | | 3.858.740 | 881.062,45 | 4.739.802,45 |
| B | Njësia Administrative Strum | | | | |
| | -VITI 2011 | 15 | 217.225 | 47.572,28 | 264.797,28 |
| | -VITI 2012 | 16 | 221.500 | 48.508,50 | 270.008,50 |
| | -VITI 2013 | 19 | 266.050 | 58.264,95 | 324.314,95 |
| | -VITI 2014 | 18 | 471.000 | 103.149,00 | 574.149,00 |
| | -VITI 2015 | 23 | 543.000 | 118.917,00 | 661.917,00 |
| | -VITI 2016 | 38 | 729.214 | 159.697,90 | 888.911,90 |
| | -VITI 2017 | 45 | 1.060.220 | 232.188,18 | 1.292.408,18 |
| | -VITI 2018 | 41 | 826.279 | 180.955,10 | 1.007.234,10 |
| | -VITI 2019 | 46 | 1.163.270 | 254.756,10 | 1.418.026,10 |
| | SHUMA (B) | | 5.497.758 | 1.204.009,01 | 6.701.767,01 |
| C | Njësia Administrative Kuman | | | | |
| | -VITI 2011 | - | - | - | - |
| | -VITI 2012 | - | - | - | - |
| | -VITI 2013 | - | - | - | - |
| | -VITI 2014 | 2 | 68.240 | 14.944,56 | 83.184,56 |
| | -VITI 2015 | 6 | 196.600 | 43.055,40 | 239.655,40 |

më sipër, kap vlerën **183.726.120** lekë, gjendje kjo e mbartur për arësye objektive (pamundësi likuiditeti).

Në mënyrë analitike, të dhëna më të plota për gjendjen e këtyre detyrimeve (deri më 30.09.2020), i gjejmë në pasqyrën si më poshtë :

Në Lekë

| Nr. | EMËRTIMI | LLogaria | Numri i Subjekteve | Shuma e Palikuiduar |
|-----|-------------------|----------|--------------------|---------------------|
| 1. | Vendime Gjyqësore | 4864100 | 1 | 19.372 |
| 2. | Shërbime | 4865200 | 17 | 1.464.355 |
| 3. | Mirëmbajtje | 4864300 | 14 | 4.218.147 |
| 4. | Të Tjera (Mallra) | 4864900 | 40 | 9.120.757 |
| 5. | Investime | 4864400 | 52 | 168.903.489 |
| | TOTALI | | 123 | 183.726.120 |

D. Verifikimi i Rregjistrit të prokurimeve për fondet publike (mallra, shërbime, punë publike), të depozituar pranë Degës së Thesarit në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe ndaj çdo rishikimi të tij gjatë vitit ushtrimor.

Nga verifikimi dhe kqyrja e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Prokurimeve dhe Drejtoria Ekonomike për përgatitjen dhe hartimin e Rregjistrit të Parashikimit të Prokurimeve Publike të Institucionit të Bashkisë Roskovec, **konstatohet** se, në mbështetje të Ligjit nr. 103/2018 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 823, datë 23.11.2016, neni 4, si dhe të Udhëzimit të APP-së, nr. 1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e Rregjistrit të Parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe Rregjistrit të Realizimeve të procedurave të prokurimit publik, si dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”, për çdo vit buxhetor (në fillim të tij) është depozituar pranë Degës së Thesarit Fier ky Rregjistër Parashikimi (dërguar jo vetëm me postë elektronike, por edhe me shkresë zyrtare). Kështu, për vitin ushtrimor 2019, krahas depozitimit të tij në fillim të vitit pranë Degës së Thesarit, kësaj të fundit me shkresën nr. 1888 prot, datë 16.04.2019, i është dërguar Rregjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike të Institucionit të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative të saj, **i Rishikuar**. Po kështu, për vitin ushtrimor 2020, është depozituar pranë Degës së Thesarit Fier, Rregjistri i Parashikimeve me shkresën nr. 647, datë 03.02.2020. Vërehet se, ky Rregjistër përgjatë vitit ka pësuar **ndryshime**, për të cilat Autoriteti Kontraktor (Bashkia Roskovec) i ka dërguar Degës së Thesarit **Rregjistrin e ndryshuar të Parashikimeve të Prokurimeve Publike**, respektivisht me shkresat (nr. 3000/1, datë 26.06.2020, nr.3796, datë 29.07.2020, nr. 4259, datë 26.08.2020, nr. 4931, datë 24.09.2020 dhe nr. 5610, datë 21.10.2020).

V. Plan Veprimi.

Bazuar në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 21, pika 7, të konkluzioneve të auditimit të plotë (për detyrimet e prapambetura) të

ushtruar në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Drejtorinë Ekonomike të Bashkisë Roskovec për periudhën deri 30.09.2020, grupi i punës së auditëve

Rekomandon :

1. Të bashkëpunohet me struktura të tjera shtetërore, për realizimin e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe Institucioni i Bashkisë Roskovec të mos hyjë në marrëdhënie financiare e të mos kryejë asnjë shërbim me subjektet dhe personat debitorë.

2. Të punohet më mire nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore për reduktim të vlerës dhe numrit të debitorëve, në bashkëpunim edhe me strukturën e Policisë Bashkiake.

3. Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore të merren masa për ndërgjegjësimin e komunitetit bashkëqytetar, duke i informuar herë pas here për shlyerjen e detyrimeve (për Taksat dhe Tarifat vendore) që ata kanë ndaj pushtetit vendor.

4. Të hartohet plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin korrent dhe për periudhën afatmesme.

5. Të përgatitet Plani i Masave që parashikohet të ndërmerren për parandalimin e krijimit të këtyre detyrimeve në të ardhmen.

6. Të vazhdojë arkëtimi për detyrimet e mbetura pa arkëtuar nga taksat, tatimet e tarifat vendore në shumën **100.642.465** lekë, për **3.558** familje dhe **173** subjekte private debitore, si më poshtë :

- Për “Taksën e Tokës”, në shumën **63.274.696** lekë për **2849** familje ;
- Për “Taksën e Ndërtesës”, në shumën **14.729.279** lekë për **3557** familje ;
- Për “Taksën e Trullit”, në shumën **123.184** lekë për **3557** familje ;
- Për “Taksa e Tarifa të Tjera”, në shumën **8.047.622** lekë për **3558** familje ;
- Për Subjektet private, në shumën **14.590.868** lekë për **173** subjekte.

7. Të merren masa që nga ana e Institucionit të Bashkisë Roskovec, të mundësohet, por edhe të kryhet likuidimi i plotë për detyrimet e mbetura pa likuiduar në shumën **183.726.120** lekë, për **123** subjekte private fizike e juridike, si më poshtë :

- Vendime Gjyqësore, në shumën **19.372** lekë për **1** person ;
- Për “Shërbime”, në shumën **1.464.355** lekë për **17** subjekte ;
- Për “Mirëmbajtje”, në shumën **4.218.147** lekë për **14** subjekte ;
- Për “Të Tjera (Mallra)”, në shumën **9.120.757** lekë për **41** subjekte ;
- Për “Investime”, në shumën **168.903.489** lekë për **52** subjekte.

Për sa më sipër, hartohet ky Projekt Raport Auditimi në 3 (tre) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i lihet Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Roskovec, dhe mbas nënshkrimit si më poshtë, 1 (një) kopje i dorëzohet grupit të auditimit.

D/DREJTORISË EKONOMIKE

Selman ÇEPELE



P/SEKTORIT TË FINANCËS

Edlira TORO



P/SEKTORIT TË BIZNESIT

Ditmira DHIMA



P/SEKTORIT TË TATIM TAKSAVE

Donika GOGA



A u d i t u e s i t

Gëzim HABIL

Gilda ZYKA

Eltona ÇEPELE

